



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:213124
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05701287

C.nr.457/2015

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve M.M., i identifikuar me numër personal..., B.P., i identifikuar me numër personal...dhe V.A., i identifikuar me numër personal..., të gjithë nga K., të përfaqësuar nga avokat S.S. nga Kamenica, kundër të paditurit “S.C.”, me seli në P., rruga..., e përfaqësuar sipas autorizimit nga J.O. avokat nga Prishtina, me objekt kontesti: kompensimi i diferencës së pagës nën pagën minimale, në seancën e shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 03.05.2024 në prani të autorizuarit të paditësve, dhe të autorizuarit të paditurës, ndërsa me datë 17.05.2024, e përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësve M.M., B.P., dhe V.A., që të gjithë nga K.

II. DETYROHET e paditura “S.C.” me numër të biznesit..., me seli në P., në emër të kompensimit të diferencës së pagës neto nën pagën minimale, që paditësve secilit veç e veç, për periudhën 27.02.2012 deri me datën 18.11.2014 t’iu paguaj shumat si në vijim:

- 1) M.M. shumën në lartësi prej 1,097.38 euro në emër të pagës neto dhe në emër të kontributit pensional shumën në lartësi prej 115.52 euro.
- 2) B.P. shumën në lartësi prej 1,097.38 euro në emër të pagës neto dhe në emër të kontributit pensional shumën në lartësi prej 115.52 euro, dhe
- 3) V.A. shumën në lartësi prej 1,097.38 euro në emër të pagës neto dhe në emër të kontributit pensional shumën në lartësi prej 115.52 euro.

III. DETYROHET e paditura që secilit prej paditësve, shumat e gjykuara në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’i paguaj me kamatë ligjore dhe atë për kërkesat e arritura nga data 27.02.2012 e deri me datë 20.12.2012 si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar, ndërsa për kërkesat e arritura nga data 21.12.2012 e deri në pagesën definitive me kamatë prej 8% në vit, sipas përlllogaritjes nga dita e parashtrimit të padisë me datë 27.02.2015, e deri në pagesën përfundimtare, e të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

IV. DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën në lartësi prej 710.80 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësit M.M., me numër personal..., B.P., me numër personal...dhe V.A., me numër personal..., të gjithë nga K., të përfaqësuar sipas autorizimit nga S.S., avokat nga Kamenica, me datën 27.02.2015 kanë paraqitur padi në këtë Gjykatë, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet i padituri "S.C.", me seli në P., adresa Rr..., të i'u kompensohen shumat prej 40 euro për 48 muaj (4 vite), si dhe kontributet pensionale prej 4 euro për 48 muaj radhazi dhe atë me kamatë ligjore që nga data e ushtrimit të padisë si dhe të bëjë pagesën e shpenzimeve gjyqësore, deri në përfundimin e procedurës dhe atë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit të plotë fuqishëm nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. Paditësit, përmes padisë së parashtruar theksojnë se kanë themeluar marrëdhënie pune me të paditurën në vendin e punës si Roje - sigurim fizik i objektit tek "Shtëpia e komuniteteve për persona me aftësi të kufizuara mendore" në K., me një pagë mujore bruto prej 130 euro. Mirëpo, me nenin 57 të Ligjit të Punës, decidivisht është përcaktuar se me vendim të veçantë të Qeverisë së Republikës së Kosovës caktohet paga minimale në Kosovë duke i marrë parasysh kriteret e apostrofuara në pikat e këtij neni, ashtu që në vitin 2011 si pagë minimale me vendim të Qeverisë së Kosovës është caktuar shuma prej 130 euro për të punësuarit nën moshën 35 vjeçare, ndërsa pagë minimale prej 170 euro për të punësuarit mbi moshën 35 vjeçare, dhe që në rastin konkret vendimi i Qeverisë së Kosovës është i obligueshëm për të gjithë punëdhënësit në Republikën e Kosovës. Meqenëse paditësit janë kategori e dytë, e paditura me qëllim të pasurimit pa bazë në dëm të paditësve në kundërshtim me Ligjin e Punës dhe vendimin e Qeverisë së Kosovës ka vazhduar me pagesën e të ardhurave në shumën prej 130 euro për vitet në vijim: 2011, 2012, 2013, dhe 2014. Tutje paditësit theksojnë se disa herë kanë kërkuar nga e paditura që të ardhurat personale- pagën minimale të ja u paguaj konform ligjit aplikativ, përkatësisht vendimit të Qeverisë së Kosovës por një kërkesë e tillë ligjore paditësve nuk i është përfillur nga e paditura. Në seancën përgatitore të mbajtur më 02.04.2024 i autorizuari i paditësve ka deklaruar se mbetën në tërësi pranë padisë së dorëzuar në gjykatë me datën 27.02.2015. Ka theksuar se, për hir të parimit të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës, e precizojmë afatin kohor duke larguar afatin e parashkrimit, pasi padia është ngritur me datë 27.02.2015 dhe neni 87 i Ligjit të Punës e precizon qartë, se kërkesat monetare nga marrëdhënia e punës parashkruhen në afat prej 3 vite, atëherë si datë të fillimit të kërkesës e precizojmë datën 27.02.2012 deri me datë 18.11.2014, që i bie 33 muaj. Ndërsa, në seancën e shqyrtimit kryesor, i autorizuari i paditësve ka precizuar vlerën e objektit të kontestit, duke kërkuar që e paditura të kompensoj pjesën e pa paguar dhe atë: për M.M. në emër të diferencës së pagës neto shumën prej 1,097.38 euro, në emër të trustit pensional për të punësuarin shumën prej 57.76 euro, si dhe në emër të trustit pensional që paguhet nga punëdhënësi shumën prej 57.76 euro, për paditësin B.P. në emër të diferencës së pagës neto shumën prej 1,097.38 euro, në emër të trustit pensional për të punësuarin shumën prej 57.76 euro, si dhe në emër të trustit pensional që paguhet nga punëdhënësi shumën prej 57.76, dhe për paditësin V.A. në emër të diferencës së pagës neto shumën prej 1,097.38 euro, në emër të trustit

pensional për të punësuarin shumë prej 57.76 euro, si dhe në emër të trustit pensional që paguhet nga punëdhënësi shumë prej 57.76 euro. Të gjitha këto me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Kurse, në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësve ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë të lartcekurave, dhe nga gjykata ka kërkuar që pas administrimit të provave të aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë si të bazuar, dhe të detyroj të paditurën që të tre paditësve të ju paguaj shumat sipas precizimit të padisë si më lartë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për taksë gjyqësore 20.00 euro, për ekspertizë 150.00 euro, dhe për dy seanca gjyqësore për secilën nga 270.40 euro, në shumë e përgjithshme prej 710.80 euro.

E paditura, përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, duke theksuar se paditësit kanë pasur marrëdhënie pune me të paditurën në pozitat e cekura si në kontratë, dhe e paditura konsideron se padia e paditësve është e parakohshme, dhe e palejuar pasi që të njëjtit nuk kanë paraqitur fillimisht kërkesën të e paditura bazuar në Ligjin e Punës. Tutje, thekson se paditësit është dashur të veprojnë në harmoni me dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, dhe të paraqesin kundërshtimin e tyre në afatin e paraparë në dispozitën e paragrafit 78 të paraqesin ankesat-kërkesat e tyre që paditësit të njëjtën e kanë pranuar po me këtë datë. Andaj, në kuptim të saj gjykatës i propozojmë që padinë të konsiderojnë të pa lejuar, dhe në kuptim të nenit 391 pika f, pasi që paditësit padinë e kanë dorëzuar pa përfillur procedurat e parapara me nenet 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Ka shtuar se e kontestojnë padinë në tërësi si të pa bazuar, edhe për faktin se në këtë çështje juridike kemi të bëjmë me një kërkesë të parashkruar për arsye se paditësit kanë paraqitur padinë ku objekt i kërkesëpadisë është kërkesa për vitet 2011 deri më 2015, e që në kuptim të kësaj periudhe të afatit të paraparë me nenin 87 të Ligjit të Punës, paditësit kanë paraqitur padinë e tyre pas kalimit të afatit 3 vjeçar për paraqitjen e kërkesave monetare që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, duke pasur parasysh kohën e paraqitjes së padisë me datë 27.02.2015 e që i bie se kanë kaluar 3 vite çka do të thotë se padia e paditësve është ushtruar pas afatit ligjor të paraparë me dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, dhe dispozitat e LMD-së që e rregullojnë çështjen e parashkrimit. Paditësit në kohën kur kanë punuar për të paditurën kanë nënshkruar kontrata të punës dhe të njëjtit me këtë janë pajtuar me pozitat, kushtet, të drejtat dhe obligimet, dhe në kuptim të saj edhe me pagën për të cilën janë dakorduar. Andaj, meqenëse kontrata konsiderohet edhe ligj për palët, të njëjtit janë pajtuar me pagën dhe benefitet tjera që ju kanë takuar, dhe me këtë nuk e kanë të drejtën që të kërkojnë më shumë se sa paga për të cilën janë pajtuar palët kontraktuese si në kontratat që janë në shkresat e lëndës. Ndërsa, në seancën përgatitore dhe në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i të paditurës edhe më tutje e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve, duke qëndruar prapa pretendimeve të dhëna përmes përgjigjes në padi. Ka shtuar se, kërkesëpadisë së paditësve i mungon baza juridike, meqenëse në mes palëve nuk është kontestuese se paditësit kanë nënshkruar kontrata pune me të paditurën të cilat kontrata i kanë specifikuar qartë detyrat dhe obligimet me palët, në kuptim të nenit 10 dhe 11 të Ligjit të punës. Tutje, ka theksuar se, në kuadër të këtyre kontratave është paraparë edhe kompensimi i paditësve për punën e kryer, e për të cilën pagesë kanë qenë të njoftuar dhe kanë qenë në dijeni çdo herë kur kanë nënshkruar kontratat. E paditura sqaron se për tërë kohëzgjatjen e marrëdhënies së

punës mes paditësve dhe të paditurës, asnjëherë në asnjë formë nuk ka pasur vërejtje, ankesë apo ndonjë kundërshtim tjetër sa i përket pagës për të cilën palët janë pajtuar me nënshkrimin e kontratave të punës.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë 208.00 euro për përgjigje në padi, dhe në emër të tri seancave të mbajtura shumë prej 811.20 euro, të llogaritura sipas Tarifës së Odës së Avokatëve.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: kontrata e punës në emër të B.P. e datës 30.06.2011, kontratat e punës në emër të M.M. të datës 01.01.2011, 13.09.2011 si dhe e datës 14.09.2014, kontrata e punës në emër të V.A. e datës 13.09.2011, 14.09.2012 si dhe e datës 30.06.2011, certifikata e biznesit për të paditurën, qarkullimi bankar në emër të paditësit M.M., qarkullimi bankar në emër të paditësit B.P., qarkullimi bankar në emër të paditësit V.A., si dhe ekspertiza financiare e datës 05.04.2024.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së, e aprovoi në tërësi të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga deklarimi i palëve ndërgjyqëse, rezulton se nuk ishte kontestuese se paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune të e paditura dhe marrëdhënia e punës ka qenë e themeluar përmes kontratave të punës. Njëkohësisht, ky fakt vërtetohet edhe pasqyrat e llogarive bankare të lëshuara në emër të paditësve, nga të cilat konstatohet se paditësit brenda tërë periudhës kontestuese kanë realizuar pagat nga e paditura, përmes pagesës në llogari bankare. Nuk ishte kontestuese se raporti juridik i paditësve dhe të paditurës, kishte ndryshuar në ndërkohë, me lidhjen e kontratave të reja të punës në mes të palëve ndërgjyqëse, kontrata këto të administruara gjatë procesit gjyqësor. Me këto kontrata, raporti juridik i punës mes paditësve dhe të paditurës, ishte ndryshuar me vullnetin e të dyja palëve ndërgjyqëse, ndryshim ky që i referohej kohëzgjatjes së kontratave të punës. Më tutje, nuk ishte kontestuese se paditësit gjatë marrëdhënies së punës kanë pranuar pagën bruto në vlerë prej 130.00 euro, e po ashtu, nuk ishte kontestuese se kjo pagë ka qenë e përcaktuar me kontrata të punës. Po ashtu, nuk ishte kontestuese në mes të palëve se paditësit me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës e kishin moshën mbi 35 vjeçare, fakt ky që vërtetohet edhe përmes kontratave të punës.

Mirëpo, kontestuese në këtë çështje juridike kontestimore ishte përgjegjësia e të paditurës, nëse e njëjta është përgjegjëse për pagesën e diferencës mbi pagën e përcaktuar me kontratë e deri në lartësinë e pagës minimale.

Bazuar në kontratat e punës së paditësve dhe pretendimet e tyre, gjykata vlerëson se marrëdhënia e punës se tyre është e rregulluar me Ligjin Nr.03/L-212 të Punës, i cili në nenin 2 paragraf 1 përcakton se: *“Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës.”* Lidhur me garantimin e pagës minimale, Ligji Nr.

03/L-212 i Punës në nenin 57 paragraf 1 parasheh: *“Qeveria e Kosovës në fund të çdo viti kalendarik përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshilli Ekonomiko-Social.”* Kurse, me nenin 3 paragraf 1 nën – paragraf 1.14. të Ligjit të lartcekur, paga minimale përkufizohet: *“Paga minimale - pagesa minimale e propozuar nga KES-i ndërsa e vendosur nga Qeveria, sipas kritereve të përcaktuara me këtë në pajtim me këtë ligj;”* Më tutje, Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 04/33 i datës 17.08.2011 ka aprovuar propozimin e Këshillimit Ekonomik – Social të Kosovës, duke përcaktuar lartësinë e pagës minimale në nivelin nacional në Republikën e Kosovës për vitin 2011 në shumën prej 130.00 euro për të punësuarit deri në moshën 35 vjeçare dhe 170.00 euro për të punësuarit mbi moshën 35 vjeçare deri në moshën 65 vjeçare. Ndërsa, me nenin 3 paragraf 1 nën – paragraf 1.13 të Ligjit të Punës përcaktohet përmbajtja e kontratës së punës, sipas të cilit: *“Kontrata e Punës - akti individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën Kolektive dhe me Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.”* Kurse, më tutje me nenin 55 paragraf 1 të Ligjit të Punës, parashihet se: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.”*

Nga përmbajtja e dispozitave të lartcekura si dhe nga Vendimi Nr. 04/33 i datës 17.08.2011, gjykata vlerëson se përmes tyre është garantuar dhe përcaktuar minimumi i pagës të cilën obligohen punëdhënësit që të zbatojnë me rastin e lidhjes së kontratave të punës. Nga interpretimi i këtyre dispozitave, del se punëmarrësit nuk mund të përfitojnë më pak se shuma minimale e përcaktuar si më lartë, dhe rrjedhimisht është detyrim i punëdhënësve që të paguajnë punëtorët në nivelin e kësaj page. Kjo për faktin se, dispozitat e lartcekura të punësuarit i garantojnë të drejtën në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës, e cila kontratë e punës duhet të jetë në përputhje me dispozitat nga Ligji i Punës. Mos përmbushja e këtij obligimi, nënkupton të drejtën e punëtorëve t'i drejtohen gjykatës për të kërkuar mbrojtje gjyqësore. Marr për bazë faktin se, paga minimale sikurse me lartë, është e garantuar me akte normative, e njëjta nuk mund të përjashtohet në mënyrë të njëanshme nga punëdhënësi. Bazuar në dispozitën e lartcekur të Ligjit të Punës, kontrata e punës lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj. Kjo nënkupton se, çdo e drejtë dhe detyrim që përcaktohet përmes kontratës së punës duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës. Ndërsa në rastin konkret, meqenëse Ligji i Punës e garanton pagën minimale, duke e bartur të drejtën tek Qeveria e Kosovës, e cila në rastin konkret përmes Vendimit Nr. 04/33 i datës 17.08.2011 e ka aprovuar propozimin e Këshillit Ekonomik – Social të Kosovës, duke e përcaktuar pagën minimale për personat mbi moshën 35 vjeçare në lartësi prej 170.00 euro. Gjykata e kishte parasysh faktin se ky Vendim e përcakton pagën minimale për vitin 2011, ndërsa pas këtij viti nuk rezulton se është nxjerr ndonjë vendim tjetër për të ndryshuar pagën minimale, mirëpo meqenëse në vitin 2011 është përcaktuar dhe garantuar një standard minimal, i njëjti standard duhet të mbrohet edhe më tutje, përderisa të ndryshohet me ndonjë vendim të ri. Po ashtu, gjykata e kishte parasysh pikën 3 të Vendimit Nr. 04/33 i datës 17.08.2011 përmes të cilit është përcaktuar paga minimale, sipas të cilës pikë: *“Obligohet Autoriteti i Inspektoratit të Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi”*, mirëpo sipas kësaj gjykate kjo dispozitë e obligon Inspektoratin e

Punës të mbikëqyr zbatimin e këtij vendimi, ndërsa punëtoreve nuk ju mohon të drejtën që kërkesat e tyre t'i realizojnë në rrugë gjyqësore. Për me tepër, gjykata e kishte parasysh faktin se kontrata është nënshkruar nga të dy palët me vullnetin e tyre, mirëpo gjykata vlerëson se është obligim i punëdhënësve që me rastin e negocimit dhe përpilimit të kontratave, të njëjtat t'i negociojnë dhe hartojnë në përputhje me dispozitat nga Ligji i Punës, çka nënkupton se të njëjtit përmes këtyre kontratave duhet të garantojnë të drejtat minimale për punëtor duke përfshirë edhe të drejtën në pagë, ndërsa punëtorët në anën tjetër, meqenëse e drejta në pagë konsiderohet e drejtë themelore përmes së cilës sigurohet ekzistenca jetësore, paditësit në rastin konkret është fakt se e kanë nënshkruar kontratën nën pagën minimale dhe me të njëjtën janë pajtuar, mirëpo kjo nuk nënkupton se kanë heqë dorë nga mbrojtja gjyqësore, përkatësisht nga të drejtat e garantuara me ligj. Andaj, bazuar në këtë, gjykata vlerëson se pjesa e kontratës e lidhur në mes të paditësve dhe të paditurës përmes së cilës është përcaktuar paga në lartësi prej 130.00 euro në muaj, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës dhe rrjedhimisht paditësve ju krijohet e drejta për të kërkuar pjesën e pagës nën pagën minimale, ndërsa punëdhënësve detyrimi për të përmbushur pjesën e pagës deri në shumën e caktuar të pagës minimale.

Gjykata thekson se caktimi i një pragu minimal për pagesën e pagës minimale përmes dispozitave ligjore ka për qëllim të garantojë një nga të drejtat themelore apo fundamentale të njeriut, e cila nënkupton të drejtën për një shpërblim që siguron një ekzistencë për plotësimin e kërkesave minimale jetësore. Për më shumë, gjykata vlerëson se garantimi i pagës minimale synon mbrojtjen nga kompensimi i ulët, dhe në lidhshmëri me këtë, qëllimi i garantimit të pagës minimale lidhet edhe me atë që, ata të cilët punojnë dhe njëkohësisht kontribuojnë në shoqëri duhet të fitojnë para të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e tyre themelore dhe në të njëjtën kohë të sigurojnë familjet e tyre me të ardhura minimale të mjaftueshme.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, sipas propozimit të paditësve ka nxjerr provën përmes ekspertizës financiare nga ekspertja gjyqësore V.M.A., e po ashtu e njëjta është ftuar edhe në seancën e shqyrtimit kryesor, duke i dhënë sqarimet e nevojshme në pyetjet e palëve ndërgjyqëse. Nga kjo ekspertizë, gjykata e konstatoj diferencën e shumës nga vlera i cila i'u është paguar paditësve deri në vlerën e pagës minimale, për periudhën 27.02.2012 deri me datën 18.11.2014. Ekspertiza ka konstatuar se paditësi M.M. për periudhën e lartcekur ka realizuar të hyra nën pagën minimale dhe atë në shumën neto prej 1,097.38 euro, ndërsa në emër të kontributit në trustin pensional e cila duhet të paguhet nga punëdhënësi në emër të punësuarit shumën prej 57.76 euro, ndërsa në emër të kontributit pensional që duhet të paguhet nga punëdhënësi shumën prej 57.76 euro, për paditësin B.P. për periudhën e lartcekur ka realizuar të hyra nën pagën minimale dhe atë në shumën neto prej 1,097.38 euro, ndërsa në emër të kontributit në trustin pensional e cila duhet të paguhet nga punëdhënësi në emër të punësuarit shumën prej 57.76 euro, ndërsa në emër të kontributit pensional që duhet të paguhet nga punëdhënësi shumën prej 57.76 euro, dhe për paditësin V.A. për periudhën e lartcekur ka realizuar të hyra nën pagën minimale dhe atë në shumën neto prej 1,097.38 euro, ndërsa në emër të kontributit në trustin pensional e cila duhet të paguhet nga punëdhënësi në emër të punësuarit shumën prej 57.76 euro, ndërsa në emër të kontributit pensional që duhet të paguhet nga punëdhënësi shumën prej 57.76 euro. Ndërsa, në raport me detyrimin për pagesën e tatimit në pagë, ekspertja përmes ekspertizës dhe në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se në rastet

kur shkalla minimale është 80.00 euro, e që në rastin konkret pas zbritjes së kontributit është 33.25 euro, nuk është obligim që i njëjti të paguhet. Gjykata e vlerësoj ekspertizën e përgatitur nga ekspertja financiare, dhe të njëjtën e trajtoj si profesionale dhe të hartuar në përputhje me detyrat e caktuara paraprakisht nga gjykata sipas propozimit të paditësve.

Pasi që gjykata konstatoj se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ligjor ndaj paditësve, rezulton se i ka mbetur borxh paditësve, pagesën në emër të kompensimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e për pasojë është krijuar marrëdhënie detyrimore ndërmjet palëve ndërgjyqëse, në të cilin paditësit e ka cilësinë e kreditorit, ndërsa e paditura cilësinë e debitorit. Sipas nenit 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), parashihet se: *“Kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij.”* Gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësve, në bazë të fakteve dhe provave të paraqitura nga paditësit dhe me aplikimin e kësaj dispozite, vendosi që të detyroj të paditurën, që paditësve t’ia përmbushë detyrimin.

Lidhur me pretendimet e të paditurës, se padia e paditësve është e parakohshme, dhe e palejuar pasi që të njëjtit nuk kanë paraqitur fillimisht kërkesën të e paditura bazuar në Ligjin e Punës sipas nenit 78 dhe 79, dhe nuk kanë paraqitur kundërshtimet e tyre, gjykata vlerëson se një pretendim i tillë nuk qëndron, për faktin se dispozitat e lartcekura nuk gjejnë zbatim në rastet kur kërkesat janë të drejtuara në aspektin monetar, sikurse në rastin konkret kërkesat e paditësve. Në raport me pretendimet e të paditurës lidhur me atë se kërkesat janë të parashkruara, sepse paditësit kanë paraqitur padinë ku objekt i saj është kërkesa për vitet 2011 deri në vitin 2015, lidhur me këtë pretendim gjykata vlerëson se i njëjti është i pa qëndrueshëm, për faktin se paditësit duke e precizuar kërkesën e tyre, diferencën në paga e kanë kërkuar nga data 27.02.2012, ndërsa padia në gjykatë është paraqitur me datë 27.02.2015. Lidhur me këtë, Ligji i Punës në nenin 87 e përcakton afatin e parashkrimit, sipas të cilit: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”* Bazuar në këtë, gjykata konstatoj se paditësit kërkesat e tyre i kanë paraqitur brenda kohës apo afatit ligjor lidhur me realizimin e kërkesës së tyre, përmes rrugës gjyqësore. Kurse, sa i përket pretendimit të paditurës së paditësit kanë nënshkruar kontrata të punës dhe të njëjtit me këtë janë pajtuar me pozitat, kushtet, të drejtat dhe obligimet, dhe në kuptim të saj edhe me pagën për të cilën janë dakorduar dhe meqenëse kontrata konsiderohet edhe ligj për palët, të njëjtit janë pajtuar me pagën dhe benefitet tjera që ju kanë takuar, dhe me këtë nuk e kanë të drejtën që të kërkojnë më shumë se sa paga për të cilën janë pajtuar palët kontraktuese si në kontratat që janë në shkresat e lëndës, gjykata të njëjtën pretendim e vlerësoj si të pa bazuar. Kjo për faktin se, siç është sqaruar me lartë, është detyrim ligjor i punëdhënësve që me rastin e përpilimit të kontratave, dhe njëkohësisht lidhjes së tyre me punonjësit, të parashihet paga minimale. Në të kundërtën, çdo shumë më e vogël se paga minimale, konsiderohet që është në kundërshtim dispozita të Ligjit të Punës, dhe punëtorët e gëzojnë të drejtën që kërkesat e tyre t’i realizojnë përmes rrugës gjyqësore. Për më shumë, duke marr për bazë qëllimin e garantimit të pagës minimale, si një standard minimal i garantuar për punëmarrësit, e njëjta i mohon të drejtën punëdhënësit që të lidh kontrata me punonjësit nën këtë shumë, ndërsa në të njëjtën kohë,

punëdhënësit dhe punëmarrësit mund të bien dakord për kushte me të favorshme të punës, duke përfshirë edhe paga me të larta se paga minimale.

Lidhur me vendimin mbi kamatën sikurse në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi të detyroj të paditurën të paguaj atë nga data 27.02.2012 e deri me datë 20.12.2012 si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke u bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 01.12.2020, ndërsa për pjesën tjetër nga data 21.12.2012 e tutje gjykata e bazua në nenin 382 të LMD-së, sipas të cilit: *“1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.”* Bazuar në të lartcekurat, gjykata e obligoj të paditurën që përveç borxhit kryesor të paguaj edhe kamatën, dhe atë sipas përlllogaritjes nga data e paraqitjes së padisë 27.02.2015 e deri në pagesën definitive.

Gjykata, vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452 paragrafi 1 i LPK-së, ku është përcaktuar se shpenzimet e procedurës i paguan pala që e humb gjykimin, andaj gjykata vendosi që të detyrohet e paditura për kompensimin e shpenzimeve procedurale që i janë shkaktuar paditësve në këtë procedurë, dhe atë: në emër të taksës gjyqësore shumë prej 20.00 euro, për ekspertizë financiare shumë prej 150.00 euro, dhe për dy seanca gjyqësore për secilën nga 270.40 euro, në shumë e përgjithshme prej 710.80 euro, siç edhe është vendosur në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me dispozitat e neneve 142 dhe 143 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.457/2015, datë 17.05.2024

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.